



FEDERATA E BADMINTONIT E KOSOVËS
BADMINTON SAVEZ KOSOVO
BADMINTON FEDERATION OF KOSOVO

Tel&Fax+ 383 132 917 +383-44-211-434;
Shtëpia e sporteve Rr.“Agim Ramadani” pn, 10000 Prishtinë
www.badminton-ks.org, email:b.f.kosovo@gmail.com

RREGULLORE E PUNËS SË BORDIT EKZEKUTIV TË FEDERATËS SË BADMINTONIT TË KOSOVËS

202~~5~~²

Në përputhje me nën paragrafin 2.1. të paragrafit 2 të nenit 15 si dhe paragrafit 12 të nenit 16 të Statutit të Federatës së Badmintonit të Kosovës, Kuvendi i Federatës së Badmintonit, në mbledhjen e datës: ~~05/11/2022~~ 26.03.2025 miratoi këtë:

RREGULLORE E PUNËS SË BORDIT EKZEKUTIV TË FEDERATËS SË BADMINTONIT TË KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës, rregullat dhe procedurat e punës së Bordit Ekzekutiv të Federatës së Badmintonit të Kosovës si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e Bordit Ekzekutiv.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregullore janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e Bordit Ekzekutiv, anëtarët e BFK-së si dhe personat tjerë të cilët janë subjekt i rregullimit.

Neni 3

Bordi Ekzekutiv

1. Bordi Ekzekutiv është organ ekzekutiv i BFK-së i cili përbëhet nga 7 (shtatë) anëtar në total sikurse përcaktohet në Statutin e BFK-së.
2. Përbërja, të drejtat dhe përgjegjësitë e Bordit Ekzekutiv janë përcaktuar në nenin 8, 13, 16, 20, 25, 30, 31, 34, 36, 42, 43 dhe 44 të Statutit të Federatës së Badmintonit të Kosovës.
3. Bordi Ekzekutiv përveç të drejtave dhe përgjegjësiave të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, ka të drejtat dhe përgjegjësitë si në vijim:
 - 3.1. Kërkon raporte prej anëtarëve të Bordit Ekzekutiv dhe të përfaqësuesve të mekanizmave të Federatës për realizimin e punëve të caktuara me të cilat janë ngarkuar;
 - 3.2. Bëj zbatimin e vendimeve të Kuvendit dhe të Bordit Ekzekutiv;
 - 3.3. Marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e bordit, përveç në rastet e pamundësisë së arsyeshme.
 - 3.4. Të punojnë në ngritjen e përgjithshme të federatës, duke qenë shembull për ulje të tensioneve
 - 3.5. të respektojnë dhe promovojnë etikën morale

Neni 4

Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv

1. Bordi Ekzekutiv kryen punën e tij dhe vendos në mbledhjet e veta.
2. Në përputhje me nenin 16 paragrafin 10, Bordi Ekzekutiv mblidhet të paktën 6 (gjashtë) herë në vit dhe poashtu kur thirret nga Kryetari ose me kërkesë specifike nga katër (4) anëtarë të Bordit Ekzekutiv në afat brenda shtatë (7) ditësh. Në rast mungese të Kryetarit, mbledhjen e thërret ~~njëri nga tre~~ nënkryetari ~~jtë~~ apo njëri nga anëtarët që e autorizon Kryetari.
3. Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv si rregull mbahen me prezencë fizike. Sipas nevojës, përçështje të caktuara Bordi Ekzekutiv mund të vendosë ta mbaj mbledhjen e saj në mënyrë elektronike duke përdorur platformat digjitale në dispozicion.
4. Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv janë të mbyllura.
5. Përgjashtimisht nga paragrafi 4 i këtij neni, Bordi Ekzekutiv mund të vendos që një mbledhje e caktuar të jetë e hapur për publikun ose të mbahen me praninë e mediave.

Neni 5

Njoftimi për mbledhje

1. Njoftimi për mbledhje, detajet për vendin, kohën dhe pikat e rendit të ditës së bashku me materialin për shqyrtim, dërgohen përmes postës ose email tek: anëtarët e Bordit Ekzekutiv.
2. Njoftimi për vendin dhe kohën e mbledhjes së Bordit Ekzekutiv dërgohet jo më vonë se 5 ditë përpara datës së mbledhjes së Bordit Ekzekutiv.
3. Detajet me shkrim të propozimeve të pikave të rendit të ditës dërgohen jo më vonë se dy (2) ditë përpara datës së mbledhjes së Bordit Ekzekutiv.

Neni 6

Procedura

1. Agjenda e mbledhjes së Bordit Ekzekutiv përmban:
 - 1.1. ftesën; vendin, datën dhe kohën e mbledhjes; dhe
 - 1.2. çështjet që do të trajtohen në mbledhje.
2. Në fillim të mbledhjes, secili anëtar ka të drejtë të propozoj pikë të re të rendit të ditës. Propozimi duhet të merr aprovimin e Bordit Ekzekutiv.
3. Para fillimit të mbledhjes, bëhet verifikimi i të pranishmëve si dhe caktohet procesmbajtësi.
4. Kryetari, udhëheq mbledhjen e Bordit Ekzekutiv ndërsa një folës ka të drejtën që një here të

flasë për një propozim ose një çështje të cilën e propozon. Kryetari mund të lejoj një folës të flasë më shumë se një herë varësisht nga situata.

5. Pas përfundimit të diskutimeve për çdo pikë të rendit të ditës, Bordi Ekzekutiv merr vendim për çështjen.

6. Votimi, bëhet me një ngritje dore apo me pajisje elektronike.

Neni 7

Kuorumi dhe vendimmarrja

1. Mbledhja e Bordit Ekzekutiv mbahet kur konstatohet se ekziston kuorum prej më shumë se gjysma e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv janë të pranishëm në mbledhje.

2. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhje. Nëse anëtari ka pengesa për ardhje në mbledhje, i njëjti ka obligim paraprakisht ta njoftoj Kryetarin për mungesën e tij. Dështimi për të marrë pjesë tri herë radhazi pa arsye në mbledhjet e bordit, përbën shkas për iniciimin e procedurës së shkarkimit.

3. Vendimet e Bordit miratohen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Bordit.

4. Para votimit për çdo pikë të rendit të ditës mund të kërkohet që të konstatohet kuorumi.

5. Votimi bëhet në mënyrë të hapur me ngritjen e dorës. Në raste të veçanta, Bordi Ekzekutiv mund të vendos për votim të fshehtë.

Neni 8

Procesverbali

1. Në përputhje me nenin 6 paragrafi 3 të kësaj Rregullore, për tërë rrjedhën e mbledhjes së Bordit Ekzekutiv mbahet procesverbali, të cilin e nënshkruan Kryetari dhe procesmbajtësi.

2. Procesverbali konsiderohet i miratuar brenda 48 orëve nga momenti i dërgimit në formë elektronike dhe nuk paraqiten vërejtjet nga anëtarët e bordit ekzekutiv.

Neni 9

Mbështetja e punës së Bordit Ekzekutiv

Puna e Bordit Ekzekutiv dhe organizimi i mbledhjeve si dhe aspekteve tjera të Bordit Ekzekutiv mbështetet nga Sekretari i Përgjithshëm si dhe stafi administrativ i Federatës.

Neni 10

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja mbi punën e Bordit të Kuvendit të Federatës së Badmintonit të Kosovës të datës Punës së Bordit të Federatës së Badmintonit e datës ~~09/02/2019~~05.11.2022.

Neni 11

Aplikimi i dispozitave të Statutit

Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen në pajtim me dispozitat e Statutit të Federatës së Badmintonit.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi, tre (3) ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i Federatës së Badmintonit të Kosovës dhe publikim në faqen zyrtare të FBK-së

Përfaqësuesi i autorizuar i BFK-së

26.03.2025



Lulzim Haziri (Kryetar)